



DEPARTAMENTI I ANALIZAVE EKONOMIKE DHE STATISTIKAVE BUJQËSORE

**Analiza e tregut të drithërave  
2017-2021**

Qershor, 2022

# Tabela e përmbajtjes

Lista e tabelave .....	3
Lista e figurave .....	3
<b>1 Sipërfaqja, prodhimtaria dhe rendimenti i drithërave në Kosovë .....</b>	<b>6</b>
1.1 Sipërfaqja e kultivuar me drithëra në Kosovë .....	6
1.1.1 Sipërfaqja e kultivuar me grurë dhe misër .....	7
1.1.2 Sipërfaqja e kultivuar me drithëra tjerë.....	8
1.2 Prodhimtaria e drithërave.....	8
1.2.1 Prodhimtaria e grurit dhe misrit .....	9
1.2.2 Prodhimtaria e drithërave tjerë .....	9
1.3 Rendimenti i drithërave .....	10
1.4 Sipërfaqja e mbjellë me farë gruri dhe importi i farës së grurit.....	11
<b>2 Eksporti i drithërave .....</b>	<b>12</b>
<b>3 Importi i drithërave .....</b>	<b>13</b>
<b>4 Importi i grurit.....</b>	<b>15</b>
4.1 Importi i grurit sipas muajve.....	15
4.2 Importi i grurit sipas shteteve .....	16
<b>5 Eksporti dhe importi i miellit të grurit .....</b>	<b>17</b>
5.1 Eksporti i miellit sipas shteteve .....	17
5.2 Importi i miellit të grurit .....	18
5.3 Importi i miellit sipas shteteve.....	18
<b>6 Eksporti dhe importi i misrit dhe miellit të misrit .....</b>	<b>20</b>
6.1 Eksporti i misrit .....	20
6.2 Importi i misrit .....	20
6.3 Importi i misrit sipas shteteve .....	21
6.4 Importi i misrit sipas muajve.....	22
6.5 Importi i miellit të misrit .....	23
6.6 Importi i miellit të misrit sipas shteteve .....	23
<b>7 Çmimet mestare të grurit, misrit, miellit të grurit dhe miellit të misrit.....</b>	<b>25</b>
7.1 Çmimi mesatar i grurit.....	25
7.2 Çmimi mesatar i misrit.....	25
7.3 Çmimi mesatar i miellit të grurit .....	26
7.4 Çmimi mesatar i miellit të misrit .....	26
<b>8 Pagesat direkte për drithërat .....</b>	<b>27</b>
<b>9 Prodhimtaria e drithërave në botë .....</b>	<b>29</b>
9.1 Prodhimtaria e grurit në botë .....	29
9.2 Prodhimtaria e grurit sipas shteteve.....	30
9.3 Prodhimtaria e misrit sipas shteteve.....	30
<b>Konkluzione .....</b>	<b>32</b>

## Lista e tabelave

Tabela 1:	Sipërfaqja, prodhimtaria dhe rendimenti i drithërave, 2016-2020 .....	6
Tabela 2:	Pagesat direkte për kulturat bujqësore, 2016-2020 .....	28

## Lista e figurave

Figura 1:	Sipërfaqja e kultivuar me drithëra / ha, 2016-2020.....	7
Figura 2:	Sipërfaqja e kultivuar me grurë dhe misër / ha, 2016-2020 .....	7
Figura 3:	Sipërfaqja e kultivuar me elb, thekër, tërshërë dhe drithëra tjera / ha, 2016-2020 .....	8
Figura 4:	Prodhimtaria e drithërave në tonë, 2016-2020 .....	8
Figura 5:	Prodhimtaria e grurit dhe misrit në tonë, 2016-2020 .....	9
Figura 6:	Prodhimtaria e elbit, thekrës, tërshërës dhe drithërave tjerë në tonë, 2016-2020 .....	10
Figura 7:	Rendimenti i grurit dhe misrit në tonë / ha, 2016-2020 .....	10
Figura 8:	Rendimenti i elbit, thekrës, tërshërës dhe drithërave tjerë kokërr në tonë / ha, 2016-2020 .....	11
Figura 9:	Sipërfaqja e mbjellë me farë gruri, dhe importi i farës së grurit, (ha) .....	11
Figura 10:	Eksporti i drithërave në '000 €, 2017-2021 .....	12
Figura 11:	Importi i grurit dhe misrit në '000 €, 2017-2021 .....	13
Figura 12:	Importi i elbit, thekrës dhe tërshërës në '000 €, 2017-2021 .....	14
Figura 13:	Importi i drithërave tjerë në '000 €, 2017-2021 .....	14
Figura 14:	Importi i grurit, vlera dhe sasia, 2017-2021 .....	15
Figura 15:	Vlera dhe sasia e grurit të importuar sipas muajve, 2017-2021 .....	15
Figura 16:	Vlera për njësi të importit të grurit sipas muajve, 2017-2021.....	16
Figura 17:	Vlera e importit të grurit sipas shteteve (%) .....	16
Figura 18:	Vlera dhe sasia e miellit të grurit të eksportuar, 2017-2021.....	17
Figura 19:	Eksporti i miellit sipas shteteve, 2017-2021, vlera (%) .....	18
Figura 20:	Vlera dhe sasia e importit të miellit të grurit, 2017-2021 .....	18
Figura 21:	Vlera e importit të miellit të grurit sipas shteteve, 2017-2021, (%) .....	19
Figura 22:	Eksporti i misrit në vlerë dhe sasi, 2017-2021 .....	20
Figura 23:	Importi i misrit në vlerë dhe sasi, 2017-2021 .....	20
Figura 24:	Importit i misrit sipas shteteve, vlera (%).....	21
Figura 25:	Vlera dhe sasia e importit të misrit sipas muajve, 2017-2021.....	22
Figura 26:	Vlera për njësi të importit të misrit sipas muajve, 2017-2021.....	22
Figura 27:	Vlera dhe sasia e importit të miellit të misrit, 2017-2021 .....	23
Figura 28:	Importi i miellit të misrit sipas shteteve, vlera (%) .....	24
Figura 29:	Çmimi mesatar i grurit në fermë, 2017-2021, (kg / €).....	25
Figura 30:	Çmimi mesatar i misrit në fermë, 2017-2021, (kg / €).....	25
Figura 31:	Çmimi mesatar i miellit të grurit, 2017-2021, (kg / €).....	26
Figura 32:	Çmimi i miellit të misrit, (€/kg) .....	26
Figura 33:	Prodhimi i drithërave në botë sipas kategorive, 2021/22, në mil. tonë .....	29
Figura 34:	Sasia e prodhimit të grurit në botë sipas viteve 1990/91-2021/22, në mil. tonë .....	30
Figura 35:	Prodhuesit më të mëdhenj të grurit në botë, 2021/22, në mil. tonë .....	30
Figura 36:	Prodhuesit më të mëdhenj të misrit në botë, 2021/22, në mil. tonë .....	31

## Hyrje

Sigurimi i të dhënave të sakta statistikore, është bazë e domosdoshme për formulimin e politikave dhe marrjen e vendimeve të ndryshme, si dhe monitorimin e progresit të objektivave të përcaktuara më parë. Nisur nga rëndësia e drithërave për ushqimin e njerëzve po ashtu edhe të kafshëve Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore mbi bazën e përgjegjësisë, ka përgatitur publikimin “Analiza e tregut të drithërave në Kosovë”. Bazuar në të dhënat e prezantuara më poshtë vërejmë se drithërat e përbëjnë pjesën më të madhe të sipërfaqeve të kultivuara në Kosovë. Kjo analizë paraqet një pasqyrë për gjendjen e drithërave në Kosovë duke përfshirë të dhënat për sipërfaqen, prodhimtarinë dhe rendimentin e tyre, çmimet, eksportin, importin si dhe shtetet prej nga importohen. Përveç të dhënave të cekura më lartë gjithashtu janë përfshirë edhe informacionet e kultivimit të grurit, misrit dhe drithërave të tjera në botë.

## Metodologjia

Të dhënat për këtë analizë siç janë sipërfaqja, prodhimtaria dhe rendimenti i drithërave janë marrë nga ASK, konkretisht nga Anketa e Ekonomive Bujqësore 2020<sup>1</sup>, bazuar në mostër, sipas metodologjisë së harmonizuar me atë të Eurostatit (pyetësori, udhëzuesi, definicionet), e cila mundëson krahasueshmërinë ndërkombëtare të të dhënave. Sa i përket të dhënave të eksportit dhe importit, bazuar në memorandumun e mirëkuptimit mes MBPZhR-ës dhe ASK-ës, të njëjtat merren në baza të rregullta mujore nga ASK, pastaj ato përpunohen nga DAESB, ku shfaqen si të dhëna vjetore dhe në seri kohore, për kapitujt 01-24 e më gjerë. Përveç të dhënave të lartë përmendura në nivel vendi, në këtë publikim janë paraqitur edhe trendet dhe gjendja e prodhimit në botë<sup>2</sup> sa i përket grurit, misrit dhe drithërave tjerë, si dhe shtetet që janë prodhuese më të mëdha të drithërave.

---

<sup>1</sup> Anketa e Ekonomive Bujqësore 2020 në teren është realizuar në 34 komunat e Republikës së Kosovës. Për katër komunat në veri është bërë një vlerësim duke u bazuar në të dhënat që ishin në dispozicion nga anketat e mëhershme në bujqësi, prandaj rezultatet e prezantuara në këtë publikim janë reprezentative për tërë territorin e Republikës së Kosovës. Të dhënat janë paraqitur vetëm në nivel të Kosovës.

<sup>2</sup> <https://www.statista.com/markets/>

## **Përmbledhja**

Qëllimi kryesor i kësaj analize është ofrimi të dhënave mbi sektorin e drithërave në Kosovë, shfrytëzimin e tokës bujqësore sipas llojit të drithërave, prodhimtarinë dhe rendimentin. Nga prodhimtaria bimore sipërfaqja më e madhe e tokës së punueshme kultivohet me drithëra, që paraqet 66% të tokës së punueshme-arave. Sipërfaqja e kultivuar me drithëra në vitin 2020 ishte 124,714 ha, nga e cila sipërfaqe 80,473 ha apo 64.5% është e mbjellë me grurë, 39,684 ha apo 31.8% e mbjellë me misër, si dhe 4,557 ha apo 3.7% është e mbjellë me drithëra tjerë (elb, thekër, tërshërë dhe drithëra të tjera kokërr).

Megjithëse rritja e sipërfaqes së drithërave në vitin 2020 është vetëm 0.4%, prodhimtaria e drithërave u rrit për 15.2%, e kjo si rezultat i rritjes së rendimenteve tek të gjitha kulturat, duke filluar me kulturat kryesore, pra grurin që kishte rritje për 19.6% dhe misrin me rritje prej 6%.

# 1 Sipërfaqja, prodhimtaria dhe rendimenti i drithërave në Kosovë

Në territorin e Kosovës për shkak të llojllojshmërisë së relievit, ekzistojnë toka të ndryshme, duke filluar nga ajo e cilësisë së dobët që shtrihen në relievin kodrinoro-malor, një pjesë tjetër është tokë e cilësisë mesatare dhe pjesa më e vogël i takon cilësisë së mirë të tokës që gjendet kryesisht rreth luginave të lumenjve. Toka bujqësore me cilësi të mirë që shfrytëzohet për prodhimtari bujqësore vazhdimisht është duke u degraduar, duke iu ndërruar destinimi në toka për vendbanime, rrugë, objekte ekonomike etj. Ky degradim po ndodh në vazhdimësi për shkak të migrimit të popullsisë në zonat afër rrugëve kryesore dhe mungesës së planit hapësinor apo moszbatimin e të njëjtit.

Bazuar në të dhënat e Regjistrimit të Bujqësisë (2014), mesatarja e tokës bujqësore për kokë banori në Kosovë është shumë e vogël (0.23 ha). Fragmentimi dhe madhësia e vogël e parcelave bujqësore paraqet pengesën kryesore që pengon mbështetjen e qëndrueshme të prodhimtarisë bujqësore.

**Tabela 1: Sipërfaqja, prodhimtaria dhe rendimenti i drithërave, 2016-2020**

Kultura	2016	2017	2018	2019	2020	Ndryshimi 2020/2019 në %
<b>Sipërfaqja</b>	<b>ha</b>					
Drithëra	134,571	120,746	123,869	124,199	124,714	0.4
Grurë	89,122	80,519	81,123	80,273	80,473	0.2
Misër	41,524	35,951	38,453	39,441	39,684	0.6
Elb	1,196	1,605	1,948	1,954	1,982	1.4
Thekër	415	318	434	420	425	1.2
Tërshërë	2,156	2,320	1,797	1,975	2,009	1.7
Drithëra të tjera kokërr	157	33	113	136	141	3.7
<b>Prodhimtaria</b>	<b>t</b>					
Drithëra	562,899	477,880	441,757	459,404	529,112	15.2
Grurë	365,651	320,136	280,616	284,999	341,818	19.9
Misër	186,592	147,200	151,921	163,930	175,180	6.9
Elb	3,669	4,687	5,124	5,159	5,764	11.7
Thekër	991	866	1,049	1,010	1,153	14.1
Tërshërë	5,428	4,862	2,751	3,954	4,769	20.6
Drithëra të tjera kokërr	568	129	296	352	427	21.4
<b>Rendimenti</b>	<b>t/ha</b>					
Grurë	4.10	3.98	3.46	3.55	4.25	19.6
Misër	4.49	4.09	3.95	4.16	4.41	6.2
Elb	3.07	2.92	2.63	2.64	2.91	10.2
Thekër	2.39	2.72	2.41	2.41	2.71	12.8
Tërshërë	2.52	2.10	1.53	2.00	2.37	18.6
Drithëra të tjera kokërr	3.62	3.87	2.62	2.59	3.03	17.0


Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZHR

## 1.1 Sipërfaqja e kultivuar me drithëra në Kosovë

Gjatë analizimit të të dhënave për sipërfaqen e kultivuar me drithëra nga viti 2016-2020, vërejmë se sipërfaqja më e madhe e kultivuar me drithëra ishte në vitin 2016 me 134,571 ha,

vijuar me rënie në vitin 2017 në 120,746 ha. Nga viti 2018 e tutje ka pasur ngritje të vazhdueshme të sipërfaqes, e që kjo rritje në vitin 2020 ka qenë 0.4% krahasuar me vitin 2019.

**Figura 1: Sipërfaqja e kultivuar me drithëra / ha, 2016-2020**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

### 1.1.1 Sipërfaqja e kultivuar me grurë dhe misër

Mesatarja e grurit të kultivuar për vitet 2016-2020 është 82,302 ha. Në vitin 2016 paraqitet sipërfaqe më e madhe (89,122 ha), ndërsa sipërfaqe më e vogël ishte në vitin 2019 (80,273 ha).

Sa i përket misrit mesatarja e sipërfaqes së kultivuar me misër ishte 39,011 ha. Po ashtu edhe misri është kultivuar në sipërfaqe më të madhe në vitin 2016 (41,524 ha) ndërsa sipërfaqe e kultivuar më e vogël me misër paraqitet në vitin 2017 (35,951 ha).

**Figura 2: Sipërfaqja e kultivuar me grurë dhe misër / ha, 2016-2020**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZhR



### 1.1.2 Sipërfaqja e kultivuar me drithëra tjerë

Përveç grurit dhe misrit në Kosovë në sipërfaqe shumë më të vogël kultivohen edhe drithërat tjerë siç janë tërshëra që është kultivuar në një mesatare prej 2,051 ha për vitet 2016-2020. Pas tërshërës me një sipërfaqe të përafërt kultivohet edhe elbi (1,737 ha), thekra (402 ha) dhe drithëra tjerë kokërr (116 ha).

Figura 3: Sipërfaqja e kultivuar me elb, thekër, tërshërë dhe drithëra tjera / ha, 2016-2020




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

## 1.2 Prodhimtaria e drithërave

Sikurse sipërfaqja, ashtu edhe prodhimtaria e drithërave më e madhe ishte në vitin 2016 me gjithsej 562,899 tonë, duke pësuar një rënie në dy vitet në vijim. Në vitet '19-'20 ka pasur përsëri një rritje kështu që në vitin 2020 prodhimtaria e drithërave ishte 529,112 tonë, me një rritje në krahasim me vitin paraprak për 15.2%.

Figura 4: Prodhimtaria e drithërave në tonë, 2016-2020




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

### 1.2.1 Prodhimtaria e grurit dhe misrit

Sa i përket prodhimit të grurit nga sipërfaqja e mbjellë në vitin 2020 që ishte 80,473 ha, ka pasur prodhimtarinë prej 341,818 tonë grurë, ndërsa misri nga sipërfaqja e mbjellë 39,684 ha, po në të njëjtin vit, ka pasur prodhimtarinë në sasi prej 175,180 tonë. Sasi më e vogël e grurit ishte në vitin 2018 (280,616 tonë), ndërsa ajo më e lartë ishte në vitin 2016 (365,651 tonë). Prodhimtaria e misrit më e lartë ishte gjithashtu në vitin 2016 (186,592 tonë), ndërsa ajo më e ulët paraqitet në vitin 2017 (147,200 tonë).

**Figura 5: Prodhimtaria e grurit dhe misrit në tonë, 2016-2020**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZHR

### 1.2.2 Prodhimtaria e drithërave tjerë

Prodhimtaria më të madhe nga ky grup i drithërave ka pasur elbi në sasi 5,764 tonë në vitin 2020 me rritje prej 11.7% krahasuar me vitin paraprak. Për nga sasia e prodhimit e dyta radhitet tërshëra që kishte prodhimtarinë prej 4,769 tonë në vitin 2020 me rritje prej 20.6% për dallim nga viti 2019. Në vitet paraprake kjo kulturë ka pasur rënie, kështu që në vitin 2016 kishte prodhim në sasi prej 2,751 tonë. Thekra në vitin 2020 ka pasur prodhim prej 1,153 tonë. Sipërfaqet e mbjellura me thekër nuk janë të mëdha, rrjedhimisht edhe prodhimi për këtë drithë nuk është i lartë edhe pse ka pasur një rritje ndër vite. Në vitin 2020 ka pasur rritje për 14% krahasuar me vitin 2019. Prodhimtaria e drithërave tjerë kokërr ka qenë mjaft e ulët, në vitin 2020 ishte 427 tonë.

**Figura 6: Prodhimtaria e elbit, thekrës, tërshërës dhe drithërave tjerë në tonë, 2016-2020**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

### 1.3 Rendimenti i drithërave

Rendimenti i grurit ka pasur rënie, sidomos në vitet 2018 dhe 2019, ku rendimentit ishte 3.5 dhe 3.6 t/ha. Në vitin 2020 tek gruri paraqitet rendimenti më i lartë me rritje prej 19.6% krahasuar me vitin 2019. Misri, rendiment më të lartë ka pasur në vitin 2016, ndërsa më i ulët paraqitet në vitin 2018 që ishte në sasi prej 4.0 t/ha, ndërsa në vitin 2020 ishte 4.4 t/ha, me rritje prej 6.2% në krahasim me vitin 2019.


**Figura 7: Rendimenti i grurit dhe misrit në tonë / ha, 2016-2020**



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

Rendimenti më i lartë në grupin e drithërave të paraqitura në figurën në vijim paraqitet tek drithërat tjerë kokërr, vijuar nga elbi, thekra dhe tërshëra. Në vitin 2020 ka pasur rritje të rendimentit krahasuar me vitin 2019, sidomos tek tërshëra (18.6%), drithëra tjerë kokërr (17%), thekra (12.8%) si dhe elbi (10.2%).

**Figura 8: Rendimenti i elbit, thekrës, tërshërës dhe drithërave tjerë kokërr në tonë / ha, 2016-2020**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

## 1.4 Sipërfaqja e mbjellë me farë gruri dhe importi i farës së grurit

Përveç importit të farës së grurit në Kosovë mbillet një sipërfaqe e konsiderueshme me farë gruri e cila ka shënuar një rritje të lehtë nga viti në vit. Në vitin 2018 ishin të mbjellura 460 ha, dhe ky shtim i sipërfaqes ka vazhduar deri në vitin 2021 që ishte 664 ha dhe paraqet rritje prej 10.7% për dallim nga viti 2020. Sa i përket vlerës së importit të farës së grurit mesatarisht nga viti 2017-2021 është importuar 2.5 mil.€, ndërsa mesatarja e sasisë së importuar për të njëjtën periudhë kohore ishte 7,247 tonë.

**Figura 9: Sipërfaqja e mbjellë me farë gruri, dhe importi i farës së grurit, (ha)**




Burimi: DPBT; ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

## 2 Eksporti i drithërave

Eksporti i drithërave ishte shumë i vogël dhe kryesisht është eksportuar farë e grurit dhe e misrit. Mesatarisht për 5 vite (2017-2021) është eksportuar farë gruri në vlerë prej 107.8 mijë €, ndërsa mesatarja e vlerës së eksportit për 5 vite për farën e misrit ishte 184.5 mijë €.

Figura 10: Eksporti i drithërave në '000 €, 2017-2021




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

### 3 Importi i drithërave

Vlera e grurit dhe misrit të importuar shfaqet me ndryshime për periudhën kohore 2017-2019. Në vitin 2017 kjo vlerë ishte 16.4 mil. €, duke arritur majën e importit të grurit në vitin 2019 që ishte 24.1 mil. €. Në vitin 2020 kjo vlerë ishte 23.5 mil. €, me tendencë të rënies në vitin 2021, që në krahasim me vlerën e vitit 2020 vërehet rënie për 16.5%.

Vlera e importit të misrit ka qenë më stabile ndër vite krahasuar me vlerën e grurit. Vlerë më e lartë e Importit të misrit ishte në vitin 2021 (9.5 mil. €), ndërsa më e vogël ishte në vitin 2017 (7.7 mil. €).

**Figura 11: Importi i grurit dhe misrit në '000 €, 2017-2021**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZHR

Vlera e elbit të importuar ka qenë mjaft e vogël në vitet '17-'19, mirëpo në vitin 2020 vërehet një rritje krahas viteve tjera, që për dallim me vitin 2019 ka pasur rritje për 11.9 herë, ndërsa krahasuar me vitin 2021 për 11.0%. Në vitin 2017 vlera e tërshërës ishte 36 mijë € ndërsa në vitin 2018 pati rënie, duke vazhduar kështu edhe në vitin 2019. Në vitin 2020 kjo vlerë ishte 17 mijë €, që vijoi me rënie për 13.6% në vitin 2021.

Thekra ka pasur vlerë më të vogël por një vazhdimësi të rritjes nga viti 2017 që ishte 6 mijë €, në 18 mijë € në vitin 2019, duke vijuar me rritje në vitin 2021. Vlera prej 21 mijë € ishte në vitin 2021, me rritje prej 57.1% në krahasim me vitin 2019, dhe njëkohësisht paraqitet si vlerë më e lartë e importit për këto vite.


**Figura 12: Importi i elbit, thekrës dhe tërshërës në '000 €, 2017-2021**



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

Vlera e importit të drithërave tjerë (orizi dhe drithëra tjerë) për vitet 2017-2020 ka qenë e përafërt, e që mesatarisht ishte 5.6 mil. €, ndërsa në vitin 2021 vlera është rritur në 6.5 mil. €, ku vërehet një rritje në krahasim me mesataren për 14.8%.

**Figura 13: Importi i drithërave tjerë në '000 €, 2017-2021**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

## 4 Importi i grurit

Sasia e grurit ka qenë e ndryshme për pesë vitet e prezantuara në figurën e më poshtme, e që më e madhe shfaqet në vitin 2020 që ishte 121,167 tonë, derisa sasia më e vogël ishte në vitin 2021 (88,327 tonë) që paraqet rënie për dallim nga viti 2020 për 27.1%. Vlerë më e lartë e importit të grurit ishte në vitin 2019 (24.1 mil. €), ndërsa më e vogël në vitin 2017 (16.4 mil. €). Në vitin 2021 vlera e grurit të importuar ishte 19.7 mil. €, që shfaqet me rënie për 16.5% krahasuar me vitin 2020.

Figura 14: Importi i grurit, vlera dhe sasia, 2017-2021




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

### 4.1 Importi i grurit sipas muajve

Gjatë analizimit të të dhënave të importit të grurit sipas muajve vërehet se viti me më shumë ndryshime krahas viteve të tjera ishte 2020, ku ka pasur shumëfishim si në vlerë po ashtu edhe në sasi, sidomos në muajin mars dhe prill, ndërsa më së paku është importuar në muajin tetor dhe dhjetor.

Figura 15: Vlera dhe sasia e grurit të importuar sipas muajve, 2017-2021




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR



Sa i përket çmimit për njësi të importit, vërehet se në vitin 2021 ka pasur vlerë më të lartë të çmimit për njësi të importuar, me ndryshim më të madh nga muaji maj deri në muajin dhjetor.

**Figura 16: Vlera për njësi të importit të grurit sipas muajve, 2017-2021**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

## 4.2 Importi i grurit sipas shteteve

Sipas të dhënave të prezantuara në figurën në vijim për importin e grurit sipas shteteve, Serbia radhitet e para për import të drithërave (përveç vitit 2019). Pjesëmarrje më të madhe në importin e grurit ka Serbia, nga i cili shtet vetëm në vitin 2019, si pasojë e masave të reciprocitetit nuk ka pasur import të grurit. Në vitin 2017, rreth 93% të grurit është importuar nga Serbia, ndërsa vitet tjera mbi 50% e sasisë së grurit po ashtu është importuar nga po i njëjti vend. Vendet tjera prej nga Kosova importon më së shumti grurë janë Hungaria, Bullgaria, Kroacia, Austria dhe Rusia.

**Figura 17: Vlera e importit të grurit sipas shteteve (%)**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

## 5 Eksporti dhe importi i miellit të grurit

Sasia më e madhe e miellit të eksportuar ishte në vitin 2017 (20,626 tonë), duke vijuar me rënie në vitet në vijim. Në vitin 2021 sasia e eksportit të miellit u rrit për 62% në krahasim me vitin paraprak. Vlera e miellit gjithashtu ishte më e lartë në vitin 2017 (4.2 mil. €), duke pësuar rënie në vitet '18 -'19, që ka vijuar me rritje në vitet '20-'21 e që në vitin 2021 ishte për 68.3%, më e lartë krahasuar me vitin 2020.

Figura 18: Vlera dhe sasia e miellit të grurit të eksportuar, 2017-2021




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZhr

### 5.1 Eksporti i miellit sipas shteteve

Eksport më i madh i miellit për vitet 2017-2021 është realizuar me Shqipërinë, nisur nga viti 2017 ku është realizuar 95%, në vitin 2018 pjesëmarrja ishte (91%) dhe 62% në vitin 2019. Pjesëmarrja e eksportit në vitin 2020 del të jetë 68% dhe në vitin 2021 ishte 79%. Pjesëmarrje tjetër në eksport të miellit të grurit sipas viteve kishte në Rep. Qendrore të Afrikës, në Mali, në Maqedoninë veriore dhe në vendet tjera.

**Figura 19: Eksporti i miellit sipas shteteve, 2017-2021, vlera (%)**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

## 5.2 Importi i miellit të grurit

Vlera e importit të miellit të grurit (miell prej grurit të zakonshëm dhe speltit, miell meslini dhe miell prej grurit të fortë durum) në vitin 2017 ishte 6.8 mil. €, që u karakterizua më rënie në vitin 2018. Vlerë më e lartë paraqitet në vitin 2020 që arriti në 8.7 mil. €, që në krahasim me vitin 2021 ishte 5.7 mil. €, vërehet një rënie prej 35%.

**Figura 20: Vlera dhe sasia e importit të miellit të grurit, 2017-2021**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

## 5.3 Importi i miellit sipas shteteve

Kur flasim për pjesëmarrjen e shteteve prej nga Kosova ka importuar miell në vitin 2021 mund të radhiten si në vijim: Kroaci 26%, Austri 22%, Maqedoni e veriut 18%, Hungari 15%, Serbi 6% si dhe 13% nga shtete tjera. Në vitin 2017, Serbia merr pjesë në import 76%, B. Hercegovina 4%, Austria 12%, Hungaria 5% si dhe shtetet tjera.

Pjesëmarrja e Serbisë në importin e miellit në vitin 2018 ishte 28%, B. Hercegovina 27%, Austria 18%, etj. Në vitin 2019 import më të madh kishte nga Maqedonia e veriut 39%, Hungaria 17%, Kroacia 16% dhe Austria 17%, kurse nga Serbia në këtë vit nuk ka pasur fare import për shkak të aplikimit të taksës doganore 100%. Në vitin 2020, Serbia merr pjesë me 18%, Kroacia 15%, Maqedonia e veriut 13%, Shqipëria 10%, Bullgaria 9% dhe vendet tjera që kishin pjesëmarrje më të vogël.

**Figura 21: Vlera e importit të miellit të grurit sipas shteteve, 2017-2021, (%)**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZhr

## 6 Eksporti dhe importi i misrit dhe miellit të misrit

### 6.1 Eksporti i misrit

Në eksportin e misrit përfshihen farë e misrit hibrid i thjeshtë, farë e misrit hibrid dhe misër për konsum. Eksporti i misrit në vitin 2017 ishte 113 mijë €, deri sa në vitin 2020 arriti në 369 mijë €. Në vitin 2021 ka pasur rënie në vlerë të eksportit të misrit për 64.4% për dallim nga viti paraprak. Eksporti prej 41 tonë, në vitin 2017 shfaqet si sasi më e vogël, ndërsa sasia e eksportit prej 255 tonë del të jetë më e lartë, e që paraqitet në vitin 2020.

Figura 22: Eksporti i misrit në vlerë dhe sasi, 2017-2021




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

### 6.2 Importi i misrit

Në vlerën dhe sasinë e importit të misrit është përfshirë vetëm misri për konsum por jo edhe fara e misrit. Mund të thuhet se importi i misrit ka qenë më i njëtrajtshëm si në vlerë po ashtu edhe në sasi. Vlerë më e madhe e misrit të importuar ishte në vitin 2017 (7.7 mil.€).

Figura 23: Importi i misrit në vlerë dhe sasi, 2017-2021



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

### 6.3 Importi i misrit sipas shteteve

Në vitin 2017, vlera e importit të misrit ka dominuar nga Serbia (93%), Bullgaria (5%) si dhe Austria me 2%. Shtetet tjera si Turqia dhe Maqedonia e veriut kanë pasur pjesëmarrje shumë të vogël.


Edhe në vitin 2018 më së shumti është importuar nga Serbia, në pjesëmarrje prej 85%, Kroacia 7%, Hungaria 6% dhe Bullgaria 2%. Përqindje më e ulët paraqitet për vendet siç janë: Federata Ruse, Turqia dhe Maqedonia e Veriut.

Situatë krejt ndryshe paraqitet në vitin 2019, që për dallim nga vitet tjera ku Serbia ka dominuar në pjesëmarrje në importin e misrit, në këtë vit për shkak të reciprocitetit të zbatuar nga ana e Kosovës për mallrat e Serbisë nuk është importuar fare misër nga ky vend. Importi i misrit, pastaj ka qenë i drejtuar nga vendet tjera siç janë: Hungaria 22%, Kroacia 36%, Bullgaria 35%, Ukraina 6% dhe Maqedonia e veriut 1%.

Pas largimit të taksës për mallrat që vijnë nga Serbia, në vitin 2020 përsëri nga ky vend pjesëmarrja në import të misrit ishte 53%, vijuar nga Austria 16%, Kroacia 14%, Hungaria 13%, dhe nga Federata Ruse 4%. Gjermania, Holanda, Italia dhe Maqedonia e Veriut kanë pasur pjesëmarrje shumë të ulët krahasuar me vendet tjera.

Në vitin 2021, përsëri del të jetë Serbia, si shtet me pjesëmarrje më të madhe e që ishte 84%, Austria 10% dhe Kroacia 6% si dhe shtete tjera që kishin vlerë shumë të vogël.

Figura 24: Importit i misrit sipas shteteve, vlera (%)




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZhr

## 6.4 Importi i misrit sipas muajve

Rritje e vlerës së importit të misrit sipas muajve vërehet nga viti 2020 sidomos viti 2021, ku ka pasur rritje në muajt 10-12 krahas viteve tjera, ndërsa vlerë më e vogël e importit paraqitet nga muaji maj deri në shtator të vitit 2021. Në sasinë e misrit sipas muajve, ndryshime më të mëdha paraqiten në vitin 2020 sidomos gjatë muajve korrik, shtator dhe tetor.


**Figura 25: Vlera dhe sasia e importit të misrit sipas muajve, 2017-2021**



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Sikurse tek gruri po ashtu edhe tek misri vërehet ndryshim në vitin 2021, ku vlera për njësi të importit në muajin janar ishte 0.18 €/kg, duke vazhduar me rritje të vazhdueshme deri në muajin dhjetor që ishte 0.24 €/kg.

**Figura 26: Vlera për njësi të importit të misrit sipas muajve, 2017-2021**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

## 6.5 Importi i miellit të misrit

Sasia e importit të miellit të misrit ka ndryshuar nga viti në vit, kështu që viti 2017 konsiderohet si vit me sasi më të madhe të miellit të importuar (1,963 tonë) në anën tjetër në vitin 2019 ishte sasi shumë e vogël e importuar, vetëm 8 tonë. Në vitin 2021 kjo sasi ishte 1,822 tonë.

**Figura 27: Vlera dhe sasia e importit të miellit të misrit, 2017-2021**




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

## 6.6 Importi i miellit të misrit sipas shteteve

Nga shtetet e paraqitura në tabelë vërejmë se pjesëmarrje më të madhe në importin e miellit të misrit ishte nga Serbia ku në periudhën '17-'18 dhe '20-'21 ishte mbi 95%. Në vitin 2019, paraqitet një pjesëmarrje komplet tjetër e shteteve prej nga është realizuar importi i misrit, kështu që në këtë vit Maqedonia e Veriut ka pasur pjesëmarrje prej 53.3%, Belgjika 21% dhe vendet tjera 25.7%. Në vitet 2020 dhe 2021, sërish importi më i madh i miellit të misrit ishte nga Serbia me pjesëmarrje prej, 96.7% dhe 98.5%.



Figura 28: Importi i miellit të misrit sipas shteteve, vlera (%)




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

## 7 Çmimet mestare të grurit, misrit, miellit të grurit dhe miellit të misrit

### 7.1 Çmimi mesatar i grurit

Figura e më poshtme tregon vlerat mesatare të çmimit të grurit për 5 vitet e fundit, ku mund të vërehet se çmimet e grurit për kg janë rritur vazhdimisht me përjashtim të vitit 2019 dhe janë në nivelin më të lartë që janë parë në serinë kohore.

Figura 29: Çmimi mesatar i grurit në fermë, 2017-2021, (kg/€)




Burimi: DAESB-MBPZhR

### 7.2 Çmimi mesatar i misrit

Çmimi mesatar i misrit kokërr në vitin 2017 ishte 0.21 € /kg, duke u rritur në vitin 2018 në 0.26 € /kg. Në vitin 2021 çmimi mesatar i misrit kokërr ishte 0.28 që kishte rritje për 12 % krahasuar me vitin 2020.

Figura 30: Çmimi mesatar i misrit në fermë, 2017-2021, (kg/€)




Burimi: DAESB-MBPZhR

### 7.3 Çmimi mesatar i miellit të grurit

Ecuria e çmimeve gjatë periudhës 2017-2021 ka pasur ndryshime. Në vitin 2017 dhe 2018 çmimi i miellit të bardhë të grurit ishte 0.58 €/kg, vijuar me rënie në vitin 2019 dhe 2020. Çmimi për kg të miellit të grurit në vitin 2021 ishte rreth 0.55 €/kg, që në krahasim me vitin 2020 ka pasur rritje për 3.8%.

Figura 31: Çmimi mesatar i miellit të grurit, 2017-2021, (kg/€)




Burimi: DAESB-MBPZhR

### 7.4 Çmimi mesatar i miellit të misrit

Në vitin 2021 ashtu si edhe çmimet e produkteve tjera, çmimi për një kilogram me pakicë miell misri në Kosovë u rrit duke arritur në 0.81 €/kg, që në krahasim me dy vitet e fundit, çmimi i miellit të misrit në vend është rritur për 11% në krahasim me vitin 2020 dhe 12.5% në krahasim me vitin 2019.

Figura 32: Çmimi i miellit të misrit, (€/kg)



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

## 8 Pagesat direkte për drithërat

Në vitin 2020, shuma totale e pagesave direkte për kultura bujqësore duke përfshirë verën dhe sigurimin bujqësor ishte 41.3 mil. €. Pjesëmarrje më të madhe në totalin e pagesave direkte për kultura bujqësore kishin gruri 34%, misri 21% si dhe kulturat tjera 45%.

Numri i ha të paguar për grurë në vitin 2020 ishte 48,931 ha, apo 33% më shumë se në vitin 2019, ndërsa nr. i ha të misrit ishte 28,493 ha, që kishte rritje në vitin 2020, krahas vitit paraprak për 4%, si dhe drithërat tjerë të prezantuar në tabelën në vijim. Informatat në tabelën e më poshtme paraqesin nr. e aplikuesve, nr. e përfituesve, nr. e ha të paguar, pagesa për ha dhe shuma totale e paguar.

Pagesat për njësi të paraqitura në tabelën e më poshtme si dhe shuma e paguar për vitin 2020 përfshinë përveç programit të rregullt të pagesave direkte edhe mbështetjen në kuadër të programit të rimëkëmbjes ekonomike.

**Tabela 2: Pagesat direkte për kulturat bujqësore, 2016-2020**


Kultura		2016	2017	2018	2019	2020	Ndryshimi 2020/2019 në %
Grurë	Numri i aplikuesve	11,864	9,709	10,683	8,872	11,044	24
	Numri i përfituesve	11,602	9,216	10,311	8,698	10,729	23
	Numri i ha të paguar	50,180	38,542	43,673	35,287	46,931	33
	Pagesa për ha	150	150	150	150	300	100
	<b>Shuma totale e paguar</b>	<b>7,526,999</b>	<b>5,781,300</b>	<b>6,550,929</b>	<b>5,292,996</b>	<b>14,079,396</b>	<b>166</b>
Farë gruri	Numri i aplikuesve	25	11	11	15	25	67
	Numri i përfituesve	25	11	11	15	24	60
	Numri i ha të paguar	803	508	458	562	869	55
	Pagesa për ha	250	250	250	250	500	100
	<b>Shuma totale e paguar</b>	<b>196,678</b>	<b>122,003</b>	<b>114,204</b>	<b>140,395</b>	<b>434,540</b>	<b>210</b>
Misër	Numri i aplikuesve	7,985	8,598	8,432	9,526	10,020	5
	Numri i përfituesve	7,763	8,231	8,165	9,370	9,808	5
	Numri i ha të paguar	19,140	22,077	21,519	27,483	28,493	4
	Pagesa për ha	150	150	150	150	300	100
	<b>Shuma totale e paguar</b>	<b>2,870,969</b>	<b>3,311,579</b>	<b>3,227,784</b>	<b>4,122,464</b>	<b>8,547,885</b>	<b>107</b>
Elb	Numri i aplikuesve	151	227	316	273	242	-11
	Numri i përfituesve	133	208	306	267	233	-13
	Numri i ha të paguar	251	387	518	488	442	-9
	Pagesa për ha	100	100	150	150	300	100
	<b>Shuma totale e paguar</b>	<b>25118</b>	<b>38,662</b>	<b>77,688</b>	<b>73,194</b>	<b>132,645</b>	<b>81</b>
Thekër	Numri i aplikuesve	77	78	83	70	59	-16
	Numri i përfituesve	61	67	72	67	56	-16
	Numri i ha të paguar	200	170	196	196	195	0
	Pagesa për ha	100	100	150	150	300	100
	<b>Shuma totale e paguar</b>	<b>19977</b>	<b>16,957</b>	<b>29,343</b>	<b>29,423</b>	<b>58,623</b>	<b>99</b>
Tërshërë	Numri i aplikuesve	-	-	-	505	569	13
	Numri i përfituesve	-	-	-	485	538	11
	Numri i ha të paguar	-	-	-	928	1321	42
	Pagesa për ha	-	-	-	150	300	100
	<b>Shuma totale e paguar</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>139161</b>	<b>396,261</b>	<b>185</b>

Burimi: Raporti vjetor i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZhB); Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

## 9 Prodhimtaria e drithërave në botë

Prodhimtaria më e madhe e drithërave është ajo e misrit në sasi prej 1,207 mil. tonë, vijuar nga gruri 778.6 mil. tonë, orizi 509.9 mil. tonë, elb, melekuqe 65.1 mil. tonë, tërshërë 22.7 mil. tonë dhe thekër 12.7 mil. tonë.

Figura 33: Prodhimi i drithërave në botë sipas kategorive, 2021/22, në mil. tonë




Burimi: <https://www.statista.com/markets/>

### 9.1 Prodhimtaria e grurit në botë

Gruri është drithi i dytë më i prodhuar pas misrit, dhe tregtia globale e grurit është më e madhe se të gjitha kulturat e tjera së bashku. Në vitin 2020, prodhimi i përgjithshëm global i grurit ishte 762 mil. tonë. Kina, India dhe Rusia janë tre prodhuesit më të mëdhenj individualë të grurit në botë, duke zënë rreth 42.5 % të prodhimit të përgjithshëm të grurit në botë. Shtetet e Bashkuara janë prodhuesi i katërt më i madh individual i grurit në botë. Megjithatë, Bashkimi Evropian, nëse do të llogaritej si një vend i vetëm, do të ishte si vend me prodhimtari më të madhe të grurit në botë, përveç Kinës. Sasia e prodhimit të grurit në botë është rritur në vazhdimësi duke u nisur nga viti 1990/91 që ishte 592 mil. tonë, që ka vijuar me rritje të sasisë së prodhimit deri në vitin 2021/22, që arriti në 779 mil. tonë. Nëse e krahasojmë vitin 2021/2022 me vitin 1990/1991 vërehet rritje e prodhimit të grurit për 186.6 mil. tonë.

**Figura 34: Sasia e prodhimit të grurit në botë sipas viteve 1990/91-2021/22, në mil. tonë**




Burimi : <https://www.statista.com/markets/>

## 9.2 Prodhimtaria e grurit sipas shteteve

Sa i përket prodhimit të grurit sipas shteteve në vitin 2021/22, vërehet se Kina ka prodhimtarinë e grurit më të madhe në botë në sasi prej 136.9 mil. tonë, vijuar nga vendet e BE-së 138.9 tonë, India me sasi të prodhimit të grurit prej 109.5 mil. tonë, Rusia 75.0 mil. tonë, vijuar nga shtetet tjera të paraqitura në figurën në vijim.

**Figura 35: Prodhuesit më të mëdhenj të grurit në botë, 2021/22, në mil. tonë**




Burimi : <https://www.statista.com/markets/>

## 9.3 Prodhimtaria e misrit sipas shteteve

Statistikat në vijim tregojnë prodhimin e misrit në mbarë botën në vitin 2021/22, sipas vendeve, ku vërejmë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës ishin prodhuesi më i madh i misrit në botë me një vëllim të prodhimit që arriti rreth 383.9 mil. tonë, vijuar nga Kina dhe Brazili që paraqiten si vend i dytë dhe i tretë në prodhimtarinë e misrit në botë. Në vitin 2016/17, SHBA ishte përgjegjëse për më shumë se një të tretën e prodhimit global të misrit, dhe po ashtu u

eksportuan rreth 56.5 mil. tonë misër, duke e bërë vendin si eksportuesin më të madh të misrit në botë.

**Figura 36: Prodhuesit më të mëdhenj të misrit në botë, 2021/22, në mil. tonë**



Burimi: <https://www.statista.com/markets/>



## Konkluzione

Nga të gjitha bimët prej të cilave njerëzit janë të varur për ushqim, drithërat janë kulturat më të rëndësishme, ashtu siç kanë qenë që nga kohërat e lashta. Në grupin e drithërave që kultivohen në Kosovë përfshihen: gruri, misri, tërshëra, elbi, thekra, etj.

Drithërat në Kosovë kultivohen në sipërfaqe më të mëdha se sa kulturat tjera, kështu që në vitin 2020 ishin të mbjellura 124,714 ha, nga e cila sipërfaqe 64.5% është e mbjellë me grurë, 31.8% e mbjellë me misër, si dhe 3.7% ka qenë e mbjellë me drithëra tjerë (elb, thekër, tërshërë dhe drithëra të tjera kokërr).

Duke mos aplikuar masat e nevojshme agroteknike në prodhimin e grurit, misrit dhe drithërave tjerë nuk po arrihet rendimenti i kënaqshëm dhe më këtë rast nuk po arrihet prodhimtaria e nevojshme për plotësimin e tërësishëm të kërkesave vendore për konsum të drithërave.

Rrjedhimisht rendimenti i ulët në njësi të sipërfaqes së kultivuar mund të shpjegohet pjesërisht nga forma e menaxhimit të kultivimit (përdorimi i inputeve bujqësore, ujitja) dhe agroekologjia (temperatura, reshjet, cilësia e tokës).

Në vendin tonë meqenëse nuk plotësohen kërkesat me prodhimtari vendore për drithëra, nevojitet të importohen mesatarisht 158,082 tonë drithëra në vit, e që vlera e kësaj sasive të importit, sillet në vlerë prej 29.4 mil. €.

Braktisja e tokës bujqësore është duke u bërë në mënyrë të vazhdueshme për shkak të migracionit dhe emigracionit që është bërë fenomen i zakonshëm në Kosovë, ku në këtë rast intensiteti i shfrytëzimit të tokës bujqësore zvogëlohet, duke çuar në përfundimin e plotë të aktiviteteve bujqësore.

Bazuar në situatën e krijuar në botë pas krizës së pandemisë dhe rritjes së çmimeve të produkteve bujqësore në vazhdimësi, është e domosdoshme që MBPZhR-ë të krijoj lehtësira përmes masave të ndryshme në shfrytëzimin maksimal të tokës bujqësore, meqenëse janë drithërat janë kultura strategjike si ushqim bazë për popullsinë dhe për ushqimin e kafshëve.

Në vendin tonë vlera mesatare e prodhimit të grurit për periudhën 2016-2021 ishte 56.6 mil. €, ndërsa vlera mesatare e prodhimit të misrit për po të njëjtën periudhë ishte 39.9 mil. €.

Duke marr parasysh që kulturat kryesore në mesin e drithërave janë gruri dhe misri dhe po të njëjtat në vazhdimësi importohen, për të arritur nivelin e kënaqshëm të prodhimit në mënyrë që të mos jemi të varur nga importi, duhet të rritet sipërfaqja e kultivuar me grurë për rreth 27 mijë hektarë ose për 33% në raport me sipërfaqen e kultivuar në vitin 2020 dhe gjithashtu sipërfaqja me misër për rreth 10 mijë hektarë apo për 26%.